



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 5820/1 Prot.

Tiranë, më 08 3 /2017

**Drejtuar : Të gjitha Departamenteve në D.P.Doganave
Të gjitha Degëve Doganore**

Lënda : Dërgim Udhëzimi

Bashkëlidhur, po ju dërgojmë për njohje dhe zbatim Udhëzimin Nr. 01 datë 07.03.2017 (Nr. 5820/1 Prot, datë 07.03.2017) “Mbi deklarimin e thjeshtuar, për mallrat me natyrë jotregtare, të importuara rastësisht nga udhëtarët”

Degët doganore të marrin masat për të mundësuar kryerjen e deklarimit të thjeshtuar nga çdo person (udhëtar) në kompjuterin e dedikuar për këtë qëllim, me aksesin e nevojshëm në modulim përkatës të sistemit ASYCUDA World.

Merrni masa për njohje dhe zbatim.

BELINDA IKONOMI

DREJTOR-I PËRGJITHSHËM

Konceptoi: Helena Duro

Miratoi : Alban Dalani

Agron Lama

Handwritten signatures and dates:
07.03.2017
07.03.2017
07.03.17



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 5820 Prot.

Tiranë, më 07.03/2017

UDHËZIM

Nr. 01 datë 07.03/2017

“Mbi Deklarimin e Thjeshtuar, për mallrat me natyrë jo tregtare të importuara rastësisht nga udhëtarët”

Mbështetur në nenet 63, 66 të ligjit 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 10, 51, 184 dhe 188, të Ligjit 102/2014, datë 31.7.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, nenin 130, të Vendimit nr. 205 dt. 13.04.1999, të Këshillit të Ministrave “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar dhe në nenet 134 deri 141, të Vendimit nr.919, datë 29.12.2014 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe;

Në vijim të lehtësimit të procedurave për deklarimin në doganë të mallrave me natyrë jo tregtare që gjenden në bagazhin e udhëtarëve, vlera e të cilave kalojnë shumën e përjashtuar nga detyrimet në import;

Me qëllim deklarimin nëpërmjet sistemit kompjuterik doganor për të gjithë mallrat që hyjnë në territorin shqiptar dhe janë objekt i pagesës së detyrimeve të importit;


UDHËZOJ


1. Vënie në funksion në të gjithë zyrat doganore e modulit të deklarimit të thjeshtuar për të deklaruar mallrat personale që kanë vlerë mbi kufirin e përjashtimit nga detyrimet doganore.
2. Deklarimi nëpërmjet modulit të deklarimit të thjeshtuar në sistemin kompjuterik të doganës do të kryhet për mallrat në bagazhet udhëtarëve të cilat kanë natyrë jo-tregtare dhe kalojnë kufirin e vlerës të përcaktuar në nenin 135, të Vendimit nr.919, datë 29.12.2014, të ndryshuar.

3. Bagazh i udhëtarit do të konsiderohen bagazhet e dorës dhe bagazhet e hambarit të personave në udhëtim, si dhe bagazhin e mjetit personal të udhëtimit (autoveturë).
4. Deklarimi nëpërmjet sistemit kompjuterik mund të kryhet nga çdo person (udhëtar) (deklarues i drejtperdrejtë). Deklarimi do të kryhet vetëm në kompjuterin e degës doganore me asistencën e doganierit përgjegjës.
5. Deklarimi i mallrave sasia e të cilave kalon kufijtë e përcaktimeve në nenet 136 dhe 137 të Vendimit nr.919, datë 29.12.2014, nuk do të jenë objekt i deklarimit nëpërmjet modulit të deklarimit të thjeshtuar. Nëqoftëse një individ ose udhëtar importon mallra në sasi që kalon përcaktimet e sipërcituara do të jenë objekt i deklarimit me deklaratë standarte në sistemin kompjuterik të doganës.
6. Nuk do të jenë objekt i deklarimit të thjeshtuar dhe rastet kur një individ importon për nevoja personale apo familjare një produkt i cili kalon kufirin e vlerës së papërfillshme dhe ka peshë të konsiderueshme. Edhe këto raste do të jenë objekt i deklarimit me deklaratë standarte.
7. Në pikat e kalimit kufitar, punonjësit e doganës në çdo moment do të japin asistencë në rastet kur udhëtarët do të deklarojnë mallrat në bagazhin e tyre vlera e të cilave kalon kufijtë e vlerës sipas përcaktimeve në pikën 2 të këtij udhëzimi. Për këtë qëllim në çdo pikë (zyrë) doganore kufitare krahas informimit publik me njohjen e legjislacionit doganor do të vihet në dispozicion një kompjuter ku do të kryhet deklarimi i thjeshtuar nga udhëtari me asistencën e punonjësit doganor.
8. Udhëtari, pasi të jetë njohur me shumën e detyrimeve, me asistencën e punonjësit të doganës bën depozitimin e deklarimit të thjeshtuar në sistemin kompjuterik. Punonjësi i doganës regjistron dhe printon deklaratën e thjeshtuar në tre kopje, firmos dhe vulos atë dhe një kopje të saj së bashku me mallrat kundrejt arkëtimit ia dorëzon personit. Kjo deklaratë përfaqëson mandatin e arkëtimit për shumën e llogaritur dhe të mbajtur. Një kopje të deklaratës së thjeshtuar së bashku me dokumentat e paraqitura nga deklaruesi (faturë/kupon për vlerën e mallrave, kopje e dokumentit të identifikimit) bëhen pjesë e praktikës doganore të deklaratës IND 4. Në përfundim të orarit zyrtar të punës punonjësi i doganës i autorizuar për asistencën në deklarimin e thjeshtuar dhe mbledhjen e detyrimeve depoziton pranë zyrës së financës kopjen e tretë të deklaratës së thjeshtuar si dhe arkëton shumën e mbledhur.
9. Në orën 08⁰⁰ të çdo dite pune sistemi për të gjitha deklaratimet e thjeshtuara të regjistruara në një degë doganore (nga ora 08 e 1 minutë e ditës para-ardhëse deri në orën 08⁰⁰ të asaj dite) gjeneron automatikisht deklaratën doganore (DAV) IND 4 ku për çdo deklaratë të thjeshtuar të regjistruar është krijuar një "bis" në këtë deklaratë. Më pas, për këtë deklaratë doganore kryhen të gjitha veprimet sipas përcaktimeve në udhëzimin nr. 01, datë 14.01.2011 "Mbi procedurën e përpunimit të deklaratës doganore (DAV) në sistemin Asycuda World". Një kopje e deklaratës e printuar dhe e vulosur do të depozitohet pranë zyrës së financës.

10. Zyra e financës e degës doganore pasi verifikon shumën e detyrimeve të arkëtuara për deklarimet e thjeshtuara me shumën e detyrimeve në deklaratën doganore përkatëse IND 4, kryen derdhjen për çdo ditë në një nga bankat e nivelit të dytë në llogarinë e të ardhurave kryesore të administratës doganore duke specifikuar për çdo rast numrin dhe datën e deklaratës doganore për të cilën kryhet kjo derdhje. Dokumenti i lëshuar nga banka (mandati) së bashku me të gjithë deklaratat e thjeshtuara përkatëse do të jetë pjesë e dokumentacionit shoqërues të deklaratës IND 4, të cilat ruhen në arkivën e degës doganore sipas legjislacionit në fuqi.
11. Deklarimi i thjeshtuar nëpërmjet sistemit kompjuterik të doganës do të përdoret vetëm për mallrat personale të natyrës jo-tregtare, të cilat kanë detyrime doganore për të paguar.
12. Udhëzimi nr. 3, dt. 05.09.2011, shfuqizohet.
13. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen të gjithë zyrat doganore të cilat në vijimësi duhet të japin të gjithë informacionin dhe asistencën e nevojshme doganore për individët apo udhëtarët.
14. Bashkëlidhur këtij udhëzimi është udhëzuesi për përdorimin e modulit të deklarimit të thjeshtuar si dhe Aneksi I me kufijtë monetarë dhe sasiore të lejuar në bagazhin e udhëtarit.


Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.


Belinda IKONQMI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Konceptoi: Lindita Hyka  03.03.2017

Miratoi: Alban Dalani  03.03.2017

Saimir Sinani  03.03.17

Mirela Meko  03.03.17

ANEKSI 1- KUFIJTË MONETAR DHE SASIOR TË MALLRAVE NË BAGAZHIN E UDHËTARIT

Kufijtë monetarë

1. Përjashtimet e parashikuara në nenin 134 jepen për mallra, vlera e përgjithshme e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës prej 300 euro për çdo udhëtar, për mallra të ndryshme nga ato të renditura në nenet 136 dhe 137.

Në rastin e udhëtarëve me rrugë ajrore dhe rrugë detare, shuma e përmendur në paragrafin e parë do të jetë vlera ekuivalente në lekë e shumës 430 euro.

2. Për udhëtarët nën 15 vjeç, kjo shumë reduktohet në vlerën ekuivalente në lekë të shumës 150 euro.

3. Për qëllime të zbatimit të kufirit monetar të sipërpërmendur, vlera e një artikulli të veçantë nuk mund të ndahet.

4. Vlera e bagazhit personal të udhëtarit, që është importuar përkohësisht ose është riimportuar pas eksportit të përkohshëm, dhe vlera e produkteve mjekësore të nevojshme për të përmbushur nevojat personale të udhëtarit nuk merren në konsideratë për qëllime të zbatimit të përjashtimit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2.

Kufijtë sasiorë për produktet e duhanit

1. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1, të nenit 134, për produktet e duhanit, zbatohet në varësi të kufizimeve sasiorë në jo më shumë se:

a) 200 cigare;

b) 100 cigarillo;

c) 50 puro;

ç) 250 gram duhan.

Secila sasi e specifikuar në shkronjat "a" deri "ç", për qëllimet e pikës 2, të këtij neni, përbën 100 % të përjashtimit total për produktet e duhanit.

Cigarillo janë cigare, pesha maksimale e të cilave është 3 gram secila.

2. Për një udhëtar, përjashtimi mund të zbatohet për çdo kombinim të produkteve të duhanit, me kushtin që totali i sasisë (përqindjes) së përdorur nga individë të mos kalojë 100%.

Kufijtë sasiorë për produktet e alkoolit dhe pijet alkoolike

1. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1, të nenit 134, për alkoolin dhe pijet alkoolike, ndryshe nga verërat e qeta dhe birra, zbatohet mbi bazën e kufizimeve sasiorë të mëposhtme:

a) 1 litër alkool dhe pije alkoolike me fortësi alkoolike më të lartë se 22% ndaj volumit, ose alkool etilik i padenaturuar me fortësi alkoolike 80% ndaj volumit dhe më shumë;

b) 2 litra: alkool dhe pije të distiluara me fortësi alkoolike që nuk e kalon 22% ndaj volumit.

Secila sasi e specifikuar në shkronjat "a" dhe "b", për qëllimet e pikës 2, të këtij neni, përbën 100 % të përjashtimit total për produktet e alkoolit dhe pijet alkoolike.

2. Për një udhëtar, përjashtimi mund të zbatohet për çdo kombinim të produkteve të alkoolit dhe pijet alkoolike të përcaktuara në pikën 1, me kushtin që totali i sasisë (përqindjes) së përdorur nga individë të mos kalojë 100%.

3. Përjashtohen nga detyrimet e importit edhe 2 litra verë e qetë dhe 10 litra birra.

Udhëtarët nën moshën 17 vjeç

Nuk jepet përjashtim për mallrat e përmendura në nenet 136 dhe 137, për udhëtarët nën moshën 17 vjeç.

Handwritten signatures and dates:
03.03.2017
03.01.2017

MANUAL PËRDORIMI PËR MODULIN E DEKLARIMIT TË THJESHTUAR NË SISTEMIN ASYCUDA WORLD

Në sistemin Asycuda World është vendosur në funksionim moduli për deklarimin e thjeshtuar i cili do të përdoret për deklarimin e mallrave personale me natyrë jo-tregëtare, vlera e të cilave kalon kufirin e vlerës së pataksueshme. Zyrat doganore të cilat do të përdorin këtë modul, do të autorizohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Mallrat për të cilat do të përdoret ky modul si dhe kriteret janë të përcaktuar në udhëzimin e dalë për këtë qëllim, bashkëlidhur të cilit është ky manual.

Deklarimi në sistem do të bëhet vetëm nga personat (deklarues ose punonjësit doganor) të autorizuar për të përdorur këtë modul.

1. Depozitimi i deklaratës së thjeshtuar:

Depozitimi i deklaratës së thjeshtuar do të bëhet në dritaren: ASYCUDA – Traveller Declarations-Serials- Traveller Declaration-në, si më mëposhtme:




Fig. 1. Hyrja në deklaratën e thjeshtuar

A screenshot of the 'Traveller Declaration - New' form in ASYCUDA World. The form is titled 'TRAVELLER DECLARATION' and is divided into several sections. Section 1 is 'Personal Details', section 2 is 'Details of Declaration', section 3 is 'PART 3 TRAVEL DETAILS', and section 4 is 'Invoice and Payment'. The form includes fields for 'CUSTOMER DEPARTMENT', 'CUSTOMER', 'TRAVELLER DECLARATION', 'Registration No.', 'Date of receipt of declaration', 'Surname(s)', 'First Name(s)', 'Passport Number', 'Invoice currency', 'Moneda', 'Forma e pageses', 'Lloji i dergeses', 'Vendi eksportues', 'Kodi i mallit (99000000)', 'Statistical Units', 'Pasha bruto', 'Pasha neto', 'Vlera fakturo', 'Vlera në lake', 'Total value', 'Total Global Taxes', 'Detyrimet doganore', and 'Detyrimet doganore'. There are also buttons for 'Print', 'Export to XML', and 'Import from XML'.

Fig. 2. Deklarata e thjeshtuar, të dhënat e plotësohen

Në vijim plotësimi i deklaratës së thjeshtuar:

Traveller Declaration - New (1123456120)

Buttons: Back, Edit, Passage, Return

CUSTOMS DEPARTMENT
ALBANA

A. CUSTOMS OFFICE TO WHICH DECLARATION IS MADE
AL 110 Tirana

TRAVELLER DECLARATION

1. Person/Manifest

2. Registration of declaration
a. Receipt Number
b. Date of receipt

PART I: TRAVELLER DETAILS

3. Details of Declarant
a. Surname(s) ZOTO
b. First Name(s) LIDA
c. Passport ID Number 1123456120

4. Invoice and Payment
Invoice currency EUR
Means of payment

Fig. 3. Plotësimi

PART II: DESCRIPTION OF GOODS

Item category	Country of Origin	Commodity	Stat. Qty #1	Measurement #1	Stat. Qty #2	Measurement #2	Stat. Qty #3	Measurement #3	Gross weight (KG)	Net weight (KG)	Invoice value	Value in HMU
CMS GIFT	COMMERCIAL SAMPLE								0.00			0

Fig. 4. Plotësimi

PART II: DESCRIPTION OF GOODS

Item category	Country of Origin	Commodity	Stat. Qty #1	Measurement #1	Stat. Qty #2	Measurement #2	Stat. Qty #3	Measurement #3	Gross weight (KG)	Net weight (KG)	Invoice value	Value in HMU
CMS GIFT	COMMERCIAL SAMPLE	Italia										0

Fig. 5. Plotësimi

Customs officer	Calculated values	
	Total values	1,000.00 CF value 135,230
	Total Global Taxes	Total Items Taxes 30,291

Traveller Declaration **Recent Data Taxes**

Fig. 6. Plotësimi

PART II: DESCRIPTION OF GOODS

Item category	Country of Origin	Commodity	Stat. Qty #1	Measurement #1	Stat. Qty #2	Measurement #2	Stat. Qty #3	Measurement #3	Gross weight (KG)	Net weight (KG)	Invoice value	Value in HMU
CMS GIFT	COMMERCIAL SAMPLE	Italia							10.00	10.00	1,000.00	135,230

Fig. 7. Plotësimi

Në vijim faqen ku pasqyrohen llogaritja e detyrimeve doganore:




Fig. 8. Pasqyra e llogaritjes së detyrimeve

Pasi janë plotësuar të dhënat e detyrueshme bëhet verifikimi dhe më pas krijimi/depozitimi i deklaratës si me poshtë:




Fig. 9. Krijimi/depozitimi i dek. thjeshtuar

2. Regjistrimi/kontrolli

Punonjësi i doganës pas depozitimit të deklaratës, kontrollit të të dhënave me të dhënat në dokumentat e paraqitura nga individë ose deklaruesi (dokument që tregon vlerën e mallrave, kopja e dokumentit të identifikimit), bën regjistrimin e deklaratës së thjeshtuar në sistem si më poshtë:




Fig. 10. Rregjistrimi i dek. Thjeshtuar

(Handwritten signatures in blue ink)




Fig. 11. Rregjistrimi i dek. Thjeshtuar




Fig. 12. Nr. i regjistrimit i dek. Thjeshtuar si dhe të dhënat mbi një dek. të thjeshtuar

Një punonjës dogane mund të kërkojë dhe verifikojë të gjithë dek. e thjeshtuara që janë regjistruar (ose janë vetëm depozituar) në çdo kohë duke kërkuar me një nga të dhënat si më poshtë (psh me kodin e zyrës ose me çdo të dhënë tjetër).




Fig. 13. Kërkimi

Në rastin e paraqitur kemi kërkuar me kodin e zyrës dhe ne vijim shohim deklarimet që janë regjistruar në atë zyrë nga deklarues të ndryshëm.




Fig. 14. Deklarimet e thjeshtuara në një zyrë

[Handwritten signatures in blue ink]

3. Gjenerimi, pranimi i DAV-it

Deklaratat e thjeshtuara gjenerohen në një deklaratë IND 4 çdo ditë në orën 8⁰⁰ e cila gjendet në dritarën e deklaratave standarte. Asycuda-Deklaratë-Deklarim i detajuar-Gjej, duke kërkuar me një nga të dhënat (kodi doganës, deklaruesi, data etj).

Për deklarimin e thjeshtuar do të përdoret tipi importit IND 4, procedura 4000-000, kodi i deklaruesit I000, nipti i përgjithshëm I00000000M.




Fig. 15. Kërkimi i DAV-it të gjeneruar

Deklarim i detajuar kerkim

Trego te dhënat për kriterin e zgjedhur, dhe vazhdo me qelqen e dokumentit specifik

Emri	Kriteri	Vlera #1	Vlera #2
Document Status	te gjitha e barabarte	AL110000	
Clirimi i	te gjitha		
Reg. Ser.	te gjitha		
Nr Rregj	te gjitha		
Dt Rregj	te gjitha		
Ast. Ser.	te gjitha		
Nr. Pran.	te gjitha		
Data Pran.	te gjitha		
Deklaruesi	e barabarte	I000	
Referenca vitit dekl.	e barabarte	2017	
Nr Rref	te gjitha		
Tipi	te gjitha		
Gen. proc.	te gjitha		
Eksportuesi	te gjitha		
Marrësi	te gjitha		
Total taxes	te gjitha		

Fig. 16. Te dhënat për kërkim

Deklarim i detajuar kerkim

2 documents found! Please select a document and select an action from the local menu

Viti	Zyra	Deklaru	Nr Ref	Reg.	Nr Rr	Dt Rregj	Tipi	Proc.	Artk.	Ekspo	Marrësi	Total ta	Ast.	Ast.	Data	Najra
2017	AL13	I000	PAD13	R	732	11/01/	IND 4		1		1000000	60%	P	733	11/0	Green
2017	AL10	I000	100000000M		733	11/01/	IND 4		3		1000000	50-52%				Red

Fig. 17. Deklarata IND 4 e listuar

Pasi hapet deklarata kryhen të gjitha kontrollet në lidhje me deklarimet e thjeshtuara të ditës në letër. Çdo bis në deklaratë i korrespondon një deklaratë e thjeshtuar. Për këtë deklaratë kryhen

të gjitha veprimet sipas përcaktimeve në udhëzimin nr. 01, datë 14.01.2011 "Mbi procedurën e përpunimit të deklaratës doganore (DAV) në sistemin Asycuda World"




Fig. 18. Kontrolli deklaratës IND 4

Në vijim vërehet NIPT-i, deklaruesi, tipi importit, referenca lokale dhe në kutinë 31 të deklaratës janë të dhënat për çdo deklaratë të thjeshtuar (numri, data, pesha, vlera, vendi origjines)




Fig. 19. Kodet e përdorura në deklaratën IND 4

31 Kollte end. perashkrim i mallit	Shenjat dhe numrat - Nr i kontenerit/ve - Numer dhe boj pad #17AL110000P000000034 11/01/2017 ltrn #1	32 Artikulli 1 Nr	33 Kodi tarifor 99000000	000			
Nr. dhe Lloji Ctn Nbr	1 21 Kartona		34 Kodi V.O. IT	35 Pesha bruto (kg) 2.00	36 Prefer.		
Mallra të udhëtareve jo të je natyre tregtare			37 REGJIMI 4000 000	38 Pesha Neto (kg) 2.00	39 Kuota		
			40 Permbledhja e deklarates/ Dokumenti i meparshem				
44 Inf. shtesë - Deklaratës	License Nr	D.Val	D.Gty	41 Sasia e njësive të p...	42 Vlera e artikullit	43 M.V.	200 coc

Fig. 20. Të dhënat e deklaratës së thjeshtuar në deklaratën IND 4

Më pas të gjitha veprimet e doganierit janë si për deklaratën standarte.




Fig. 21. Miratimi deklarates




Fig. 22. Miratimi i deklarates




Fig. 23. Rikonalizimi deklarates




Fig. 24. Pranimi i deklarates




Fig. 25. Deklarata e pranuar

Në përfundim të veprimeve doganieri do të ruajë deklaraten bashkëlidhur së cilës janë dhe deklaratat e thjeshtuara si dhe dokumentat për secilën deklaratë (faturë, kartë identiteti) si dhe mandatin e bankës që tregon derdhjen e detyrimeve të paguara. Doganieri pranues i deklaratës doganore kryen të gjitha veprimet për dorëzimin dhe arkivimin e praktikës doganore përkatëse.